

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	611-25-5156-5-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	InfraCore Shpk
NUI	812169523
Adresa	Drenas
Vendi	Drenas
Kodi postar	13000
Numri Telefonit	049571977
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Brentian Mala
Adresa elektronike	infracoreshp@gmail.com
Data e parashtrimit të kërkesës	20.06.2025

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftim per kontrat 10.06.2025

Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuar 11.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur keto dispozita të LPP-së

Neni 1 - Qellimi

Neni 2 - Fushëveprimi

Neni 7 - Barazia në Trajtim / Jo Diskriminimi

Neni 27 - Dosja e Tenderit

Neni 28 - Specifikimet Teknike

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

1. Kërkesa juaj: **Kompania ofertuese duhet te jete e certifikuar me ISO 3834-2-2006; ISO 45001-2018; ISO 14001-2015;**

1. Kërkesa jone: Ne kerkojme qe te largohet ISO 3834-2-2006 qe eshte nje certifikatë teknike që ka të bëjë ekskluzivisht me procesin e saldimit të materialeve metalike, Ne paramasën e këtij tenderi nuk ekziston asnjë pozicion që parasheh saldim apo ndonje pune me materiale te metalit. Ky kriter eshte favorizues dhe shume diskriminues per shume OE.

2. Kërkesa juaj: **Së paku një master i arteve në menaxhimin e emergjencave, i certifikuar nga një kompani e akredituar si AUDITOR i menaxhimit per ISO 9001**

2. Kërkesa jone: Menaxhimi i emergjencave në fushën e ndërtimit dhe zbatimit të punimeve rrugore zakonisht mbulohet nga Inxhinieri i Ndërtimtarisë – profili i sigurisë në punishtet ndërtimore (ose një Inxhinier i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë). Për më tepër, përfshirja e kërkesës për t’u certifikuar nga auditorë ISO për menaxhim cilësie përbën kriter tërësisht të personalizuar për një individ të caktuar. Ne kerkojme qe ky kriter te largohet.

3. Kërkesa juaj: **Kamion kiper me vinç maksimum 2,ton me peshë bartëse, me lugë graifer, (luga te deshmohet me letrat përcjellëse për dokumentim.**

3. Kërkesa jone: Kërkesa për vinç me lugë graifer në një kamion me bartje kaq të ulët (maksimum 2 ton) nuk është teknike, është joproporcionale me nevojën reale të kontratës. Nëse ka nevojë për graifer, ai zakonisht përdoret në kamionë me kapacitet të mesëm ose të lartë, jo në mjete të lehta që nuk kanë kapacitet për të përballuar peshën dhe funksionin mekanik të graiferit. Ne kerkojme qe ky kriter te largohet ose te ndryshohet pesha e kamionit kiper me vinç.

4. Kërkesa juaj: **Semafora 4 copë me Drita Emituese me Dioda (LED) me Module Perkrahes 100 kg**

4. Kërkesa jone: Në praktikë, semaforët LED për përdorim në punime rrugore janë shumë më të lehtë dhe me konstruksione të lehtësuara që përmbushin funksionin e rregullimit të trafikut në zonat e punës. Funksioni i semaforit nuk varet nga pesha, por nga cilësia e sistemit sinjalizues dhe qëndrueshmëria në terren.

Kjo kërkesë favorizon një model të caktuar dhe përjashton operatorët ekonomik që përdorin semaforë standardë sipas direktivave EN dhe CE. Kërkojmë që përshkrimi i peshës të largohet, dhe të kërkohet vetëm përmbushja e standardeve të sinjalizimit dhe sigurisë në punime rrugore.

5. Kërkesa juaj: **Papuçe Hidraulike 20-30 ton .**

5. Kërkesa jone: Kërkojmë që të sqaroni nëse: A duhet papuçja të ketë peshë 20–30 ton, gjë që është shumë e vështirë dhe praktikisht e pamundur për t’u siguruar në treg, apo peshën 20–30 ton duhet ta ketë ekskavatori ku mund te montohet papuçja hidraulike.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale janë të konsiderueshme, pasi ne jemi duke u përgatitur për të marrë pjesë në këtë projekt dhe kemi investuar kohë, resurse dhe përgatitje teknike. Nëse, për shkak të këtyre kritereve diskriminuese dhe shkeljeve në dosjen e tenderit, nuk na mundësohet të marrim pjesë, atëherë humbja për kompaninë tonë do të jetë shumë e madhe.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*